

Rregullore pune mbi aktivitetet e Qendrave Hulumtuese

Neni 1

Qendrat hulumtuese janë njësi të pavarura akademike në kuadër të secilit fakultet. Qendrat veprojnë brenda kornizave të Universitetit AAB, në pajtim me procesin edukativ dhe hulumtues të Bolonjës.

Neni 2

Detyrat e Qendrave hulumtuese janë si vijon:

- Qëllimi i tyre kryesor është zhvillimi i punës themelore hulumtuese shkencore në fusha të ndryshme shkencore.
- Qendrat hulumtuese duhet të nxisin projekte interdisiplinare të hulumtimit në Universitet.
- Qendrat hulumtuese duhet të bashkëpunojnë me të gjithë dhe nëse është e mundur të zhvillojnë projekte të përbashkëta hulumtuese-shkencore.
- Qendrat hulumtuese duhet të bashkëpunojnë me institute hulumtuese-shkencore të jashtme, e posaçërisht me qendrat hulumtuese të universiteteve jashtë Kosovës.
- Qëllimi i qendrave hulumtuese duhet të jetë inkorporimi i aktiviteteve të tyre hulumtuese me projektet shkencore ndërkombëtare.
- Qendrat hulumtuese trimërohen për të prodhuar projekte hulumtuese-shkencore për partnerët jashtë universitetit në baza komerciale.
- Qendrat hulumtuese duhet të organizojnë tryeza të rrumbullakëta dhe konferenca kushtuar punës së tyre hulumtuese-shkencore.
- Qendrat hulumtuese duhet ta inkorporojnë në hulumtimet shkencore para së gjithash komunitetin akademik të Universitetit AAB dhe studentët e tij.
- Qendrat hulumtuese janë të lira të bashkëpunojnë me shkencëtarë të jashtëm.
- Qendrat hulumtuese duhet të inkorporojnë në aktivitetet e tyre edhe hulumtues të rinj.
- Detyrë e qendrave hulumtuese është ta informojnë publikun për aktivitetet e tyre.

Neni 3

Organet e qendrës janë si vijon:

- Këshilli i Qendrës Hulumtuese
- Koordinator i Qendrës Hulumtuese

Neni 4

Koordinatorët (drejtorët) e qendrave hulumtuese janë përgjegjës për punën e qendrave. Ata duhet të koordinojnë punën e tyre me dekanin e secilit fakultet dhe me prorektorin për hulumtime shkencore.

Neni 5

Këshilli i Qendrave Hulumtuese përbëhet prej:

- Koordinator i Qendrave Hulumtuese;
- Dekani i fakultetit përkatës (me rotacion);
- Dy anëtarë nga stafi akademik;
- Një anëtar i jashtëm nga Kosova nga komuniteti shkencor;
- Një anëtar nga Komuniteti Ndërkombëtar dhe
- Dy drejtorë të Qendrave Hulumtuese me rotacion
- Një anëtar nga zyra e Rektorit;

Dekani i fakultetit përkatës duhet të marrë pjesë në mbledhje të Këshillit të Qendrave Hulumtuese në bazë të agjendës së takimit të Këshillave të Qendrave Hulumtuese.

Dy drejtorët e qendrave zëvendësohen çdo gjashtë muaj.

Mandati i Këshillit është dy vjet.

Neni 6

Këshilli ka përgjegjësi për të miratuar programin e Qendrës Hulumtuese në baza vjetore dhe të përfshihet në aktivitetet hulumtuese të qendrës gjatë vitit.

Neni 7

Koordinatori duhet t'ia paraqesë Këshillit programin e punës jo më vonë se më 31 tetor të vitit akademik.

Neni 8

Koordinatori duhet t'i raportojë prorektorit për hulumtime shkencore për punën e qendrës rregullisht në baza mujore.

Neni 9

Detyra e prorektorit për hulumtime shkencore është të koordinojë punën e të gjitha qendrave hulumtuese të Universitetit AAB dhe të zhvillojë lidhje produktive me institucionet hulumtuese-shkencore jashtë Universitetit AAB.

Neni 10

Koordinatori duhet t'i dorëzojë zyrës së rektorit raport gjithëpërfshirës mbi aktivitetet e qendrës hulumtuese, jo më larg se 1 shtatori i secilit vit.

Neni 11

Aktivitetet e Qendrës hulumtuese financohen nga burimet vijuese:



-
- nga buxheti i Universitetit
 - Nga buxheti i shtetit
 - Nga grantet
 - Nga aktiviteti vetanak komercial
 - Nga burimet tjera.

Rektori i Universitetit
Urosh Lipuscek, PhD

Prishtinë
25.09.2008